



## **VENDIMI DHE GJETJET**

**Data e miratimit: 26 gusht 2014**

**Nr. i lëndës: 2012-21**

**Mirko Krlić**

**kundër**

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 26 gusht 2014, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese  
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar  
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga  
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor  
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore  
Z. Florian RAZESBERGER, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

### **PROCEDURA**

1. Ankesa ishte regjistruar më 6 dhjetor 2012.
2. Me 8 prill 2013, Paneli ka vendosur që ta njoftoj shëfën e Misionit (ShM) të EULEX-it në Kosovë rreth kësaj anese, duke ftuar atë që të dorëzoj me shkrim vërejtjet lidhur me ankesën. Gjithashtu ishte vendosur që ta shqyrtoj bazueshmërinë e kërkesës, si dhe pranueshmërinë e saj (Rregullorja 30, paragrafi 1 dhe 2 i rregullores së punës së Panelit (më tutje si: RrP).

3. Vërejtjet e ShM janë marrë me datën 27 maj 2013. Më pas ato ju ishin dërguar ankuesit si përgjigje për të.
4. Më 24 qershor 2013 ankuesi ka dërguar përgjigjen e tij, e cila ishte përcjellë tek ShM për njoftim.
5. Nga ShM janë kërkuar informata shtesë më 5 shtator 2013. Ato ishin pranuar më 20 nëntor 2013.

## **FAKTET**

### **I. RRETHANAT E RASTIT**

6. Ankuesi është ndihmës drejtor në Zyrën për Kosovë dhe Metohi, një organ qeveritar i Serbisë.
7. Më 22 nëntor 2012, ai kishte arritur nga drejtimi i Serbisë në kufirin administrativ, në vendkalimin Jarinjë/Rudnicë (e ashtuquajtura "Porta 1"). Ankuesi pohon se vizita e tij në Kosovë ishte e karakterit privat. Ai ishte ftuar nga prifti i kishës Shën Dimitri në Mitrovicë për të bërë vizitë në kishën e tij (22 nëntori ishte dita e dytë e festës, pra e festës së shën mihajlit).
8. Pas pritjes për dy orë në atë vendkalim, atij ju ishte refuzuar hyrja në Kosovë nga ana e Policisë Kufitare të EULEX-it. Në formularin standard për refuzimin e hyrjes që ju ishte lëshuar thuhej se "z. Mirko Krlić është zyrtar nga Serbia dhe për këtë arsye duhet të bëjnë një kërkesë zyrtare tek autoritetet kosovare para se të hyjë. Kjo përfshin edhe vizitat private". Ky formular ishte nënshkruar nga një zyrtar i Policisë Kufitare të EULEX-it. Sipas një shënimi të shkruar me dorë në atë formular, ankuesi kishte refuzuar ta nënshkruajë atë.

### **II. ANKESAT**

9. Ankuesi pretendon se duke ju mohuar atij hyrja në Kosovë dhe pjesëmarrja në festat fetare, EULEX-i ka shkelur nenin 9 (liria e besimit) dhe nenin 2 të protokollit nr. 4 (liria e lëvizjes) të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa).

### **LIGJI**

10. Ankuesi pretendon se veprimet e EULEX-it kanë shkelur nenin 9 dhe nenin 2 të protokollit nr. 4 të Konventës. Në këto dispozita, për aq sa kanë të bëjnë me to, shkruan:

**Neni 9:**

“1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së mendimit, të ndërgjegjes e të fesë; kjo e drejtë nënkupton lirinë për të ndryshuar fenë ose besimin dhe lirinë, qoftë individualisht ose kolektivisht, publikisht ose privatisht nëpërmjet kultit, mësimdhënies, praktikave dhe kryerjes së riteve.

2. Liria e shfaqjes së fesë ose besimeve të dikujt nuk mund t'i nënshtrohet kufizimeve të tjera, përveç atyre të parashikuara nga ligji dhe që përbëjnë masa të nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, të shëndetit ose të moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve”.

#### **Neni 2 i protokollit nr. 4:**

1. Kushdo që ndodhet në mënyrë të ligjshme në territorin e një Shteti ka të drejtë, brenda këtij territori, të lëvizë lirisht në të dhe të zgjedhë lirisht vendbanimin e tij.

(...)

3. Ushtrimi i këtyre të drejtave nuk mund t'ju nënshtrohet kufizimeve të tjera nga ato të parashikuara në ligj dhe të domosdoshme në një shoqëri demokratike për sigurimin kombëtar ose sigurinë publike, ruajtjen e rendit publik, parandalimin e veprave penale, mbrojtjen e shëndetit apo të moralit, ose mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve.

4. Të drejtat e parashtruara në paragrafin 1, në disa fusha të caktuara, mund t'u nënshtrohen disa kufizimeve të vendosura në përputhje me ligjin dhe të justifikuara nga interesi publik në një shoqëri demokratike”.

11. Paneli ka vendosur, *proprio motu*, që ta komunikoj lëndën dhe ta shqyrtoj atë sipas nenit 8 të Konventës, në të cilën thuhet si në vijim:

#### **Neni 8:**

1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij.

2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve”.

#### **Parashtresat nga palët**

12. Në parashtresat e tij, ShM ka pohuar se nuk ka pasur shkelje të të drejtave të njeriut të ankuesit. Në atë kohë, zyrtarët e Policisë Kufitare të EULEX-it ishin duke ushtruar funksionet e plota ekzekutive të kontrollit kufitar duke përfshirë ato që lidhen me autorizimin dhe refuzimin e hyrjes në Kosovë, në pajtim me OPLAN-in e EULEX-it Kosovës dhe në pajtim me një marrëveshje për menaxhimin e integruar të kufirit (MIK). Sa i përket hyrjes së zyrtarëve të qeverisë serbe në Kosovë, ekziston një marrëveshje joformale në fuqi, e pranuar dhe zbatuar nga Serbia dhe Kosova që nga viti 2009. Në bazë të kësaj marrëveshjeje, çdo vizitë prej ndonjë zyrtari të tillë në Kosovë kërkon që të parashtrohet një kërkesë në zyrën e zëvendëskryeministrit të Kosovës, përmes zyrave të BE-së në Beograd dhe Kosovë. ShM thekson se para kësaj ngjarje rreth së

cilës është bërë ankesa, ankuesi ishte pjesë e delegacioneve zyrtare në Kosovë, ku ai i kishte asistuar eprorit të tij, pra drejtorit të zyrës për Kosovë dhe Metohi, gjatë vizitave të këtij të fundit. Në ato raste, kërkesat për hyrjen e tij ishin parashtruar sipas procedurës së mësipërme. Kjo është edhe arsyeja pse statusi i ankuesit si zyrtar qeveritar ishte i regjistruar në bazën e të dhënave të policisë kufitare qysh para datës 22 nëntor 2012. ShM ofron një listë të kërkesave për përcjellje nga ana e policisë të personave që vizitojnë Kosovën, me emrin e ankuesit si zyrtar serb në të.

13. ShM më tej pohon se identiteti i ankuesit ishte vërtetuar nga policia kufitare në bazë të paraqitjes së dokumentit të identifikimit të Serbisë, në përputhje me Konkluzionet e Miratuara për Lëvizje të Lirë në mes të Serbisë dhe Kosovës, të datës 2 korrik 2001. ShM thekson se në bazë të nenit 28.2 të Ligjit nr. 04/L-069 për të Huaj, në fuqi në atë kohë, policia kufitare "mund të kërkojnë (...) nga i huaji që të vërtetoj (...) qëllimin e hyrjes në Republikën e Kosovës". Nuk ka shënime se ankuesi kishte paraqitur ndonjë dokument për të vërtetuar pretendimin e tij se vizita e tij ishte e një karakteri privat.
14. Për sa i përket mundësive të ankesës kundër këtij refuzimi, ShM thekson se në bazë të nenit 9.4. të Udhëzimit Administrativ nr. 03/2010-MPB për ndalimin e hyrjes në Republikën e Kosovës, personi që ju është refuzuar hyrja ka të drejtë ankese në afat prej tetë ditësh në Komisionin e Ankesave për Qëndrim të Përkohshëm.
15. ShM argumenton më tej se neni 2 i protokollit nr. 4 të Konventës nuk është i zbatueshëm në rastin në fjalë, pasi ai zbatohet vetëm për lirinë e lëvizjes së personave në mënyrë të ligjshme në territorin e një shteti.
16. Në lidhje me shkeljet e pretenduara të së drejtës për jetë private dhe familjare (neni 8 i Konventës) dhe për lirinë e fesë (neni 9 i Konventës), ShM pohon një ndërhyrja nga policia e EULEX-it ka qenë në përputhje me ligjin dhe e arsyeshme në rrethanat e caktuara. Prandaj ajo ishte brenda kufizimeve të përcaktuara nga nenet 8 paragrafi 2 dhe neni 9 paragrafi 2 të Konventës.
17. Në përgjigjen e tij ndaj këtyre vërejtjeve, ankuesi mohon se është zyrtar i qeverisë së Serbisë dhe argumenton se procedura e përshkruar nga ShM vlen vetëm për vizitat në nivel ministror dhe jo për të. Ai thotë se kurrë nuk ka udhëtuar në Kosovë me drejtorin e zyrës për Kosovë dhe Metohi. Ai thekson se karta e tij e identitetit nuk mund të shërbejë si tregues i statusit të tij si zyrtar serb dhe se nuk ju ishin kërkuar asnjë dokument tjetër nga policia kufitare. Për më tepër, ai i kishte shpjeguar policisë kufitare se vizita e tij ishte e një natyre private. Kërkesa për të ofruar dëshmi shtesë rreth natyrës së vizitës në Kosovë është e papranueshëm, pasi kjo do të nënkuptonte që serbët që vijnë në Kosovë për vizita private trajtohen si qytetarë të huaj.

18. Ankuesi thekson se të drejtat e tij në lirinë e lëvizjes dhe lirinë fetare janë shkelur. Ai thekson se çdo ndërhyrje nga autoritetet publike në ato të drejta mund të lejohet vetëm "në interes të sigurisë shtetëror, të sigurisë publike ose mirëqenien ekonomike të vendit, për parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve". Ai pohon se vizita e tij private në një kishë nuk mund ta kishte dëmtuar asnjëherë prej këtyre vlerave.

## **Vlerësimi i Panelit**

### *Mandati i Panelit (Rregulla 25 par. 1 i rregullores së punës)*

19. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar për të përdorur instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në konceptin llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.
20. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së vet të punës.
21. Nuk ishte bërë asnjë vërejtje nga palët sa i përket pranueshmërisë së ankesës.
22. Sipas rregullës 25, paragrafit 1 të rregullores së vet të punës, Paneli mund të shqyrtojë ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-i në Kosovë gjatë kryerjes së mandatit të tij ekzekutiv.
23. Paneli tashmë ka konstatuar se veprimet e policisë së EULEX-it janë pjesë e mandatit ekzekutiv të EULEX-it, prandaj ato bien në kuadër të mandatit të Panelit (shih, për shembull, *Y kundër EULEX-it*, nr. 2011-28, 15 nëntor 2012). Paneli nuk sheh ndonjë arsye tjetër që në këtë lëndë të bëj ndonjë konstatim ndryshe.

### *Shkeljet e pohuara të neneve 8, 9 dhe nenit 2 të protokollit nr. 4 të Konventës*

24. Paneli së pari do të shqyrtojë ankesën sipas nenit 8. Paneli rithekson se, në bazë të praktikës gjyqësore, e cila është vendosur mirë, të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Gjykatës) nocioni i "jetës private" në kuptim të kësaj dispozite është një koncept i gjerë që përfshin, ndër të tjera, të drejtën për të krijuar dhe zhvilluar

marrëdhënie me qenie të tjera njerëzore (shih, për shembull, çështjen *Niemietz kundër Gjermanisë*, vendim i datës 16 dhjetor 1992, Seria A nr. 251-B, p. 33, § 29; *E.B. kundër Francës* [GC], nr. 43546/02, § 43, *Pretty kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 2346/02, § 61, KEDNj 2002-III; *Oleksandr Volkov kundër Ukrainës*, nr. 21722/11, § 165, KEDNj 2013). Prandaj, Paneli pranon se kjo dispozitë zbatohet sa i përket rrethanave të kësaj lënde.

25. Paneli më tej thekson se, edhe pse thelbi i nenit 8 në esencë është mbrojtja e individit nga ndërhyrja arbitrare prej anës së autoriteteve publike, ai thjesht nuk i detyron autoritetet që të përmbahen prej ndërhyrjeve të tilla: përveç këtij veprimi kryesisht negativ, i cili është ndërmarrë, mund të ketë obligime pozitive të natyrshme në aspektin efektiv për jetën private. Kufijtë midis detyrimeve pozitive dhe negative të autoriteteve sipas nenit 8 nuk japin ndonjë definicion të saktë, por parimet e zbatueshme janë megjithatë të ngjashme. Në mënyrë të veçantë, në të dy rastet duhet të kihet parasysh ekuilibri i drejtë, i cili duhet të arrihet në mes të interesit të përgjithshëm dhe interesave individuale; dhe në të dy kontekstet autoritetet gëzojnë një kufi të caktuar të vlerësimit (shih, midis shumë autoriteteve të tjera, *Fernández Martínez kundër Spanjës* [GC], nr. 56030/07, § 114, 12 qershor 2014 *Schüth kundër Gjermanisë*, nr. 1620/03, § 55, KEDNj 2010; *Von Hannover kundër Gjermanisë*, nr. 59320/00, § 57, KEDNj 2004-VI).
26. Pyetja kryesore që lind në këtë rast është nëse EULEX-i ka pasur nevojë që në kuadër të obligimeve të tij pozitive sipas nenit 8 të mbështesë të drejtën e ankuesit që t'i respektohet jeta e tij private duke i lejuar atij të hynte në Kosovë dhe të bënte vizitë atyre që i njihen dhe një kishe atje.
27. Paneli konstaton se ankuesi nuk i ka përfillur kërkesat procedurale të në fuqi. Kërkesat që zbatohen për vizitat e zyrtarëve të qeverisë së Serbisë kanë qenë të saktësuara në marrëveshjen joformale në fuqi dhe që respektohen nga Serbia dhe Kosova që nga viti 2009. Aplikuesi nuk i ka respektuar këto, pasi ai nuk kishte paraqitur kërkesë në zyrën e zëvendëskryeministrit të Kosovës. Sipas mendimit të Panelit, ankuesi nuk ka parashtruar argumente bindëse se ai nuk mund të kishte dijeni rreth procedurës së caktuar. Ai ka një pozitë në Zyrën për Kosovë dhe Metohi dhe ka vizituar Kosovën me eprorin e tij në disa raste para ngjarjes rreth së cilës është bërë ankesa (shih kërkesat për dokumentin e shoqërimit të policisë, të paraqitur nga EULEX-i, par. 12 më lartë) dhe për këtë arsye do të duhej të jetë në dijeni të formaliteteve në fuqi.
28. Paneli do ta lë hapur çështjen nëse për qëllimet e këtij rasti, Kosova duhet të konsiderohet shtet i ndarë apo jo sa i përket kritereve për hyrje.
29. Duke pasur parasysh si më sipër, Paneli konsideron se Policia Kufitare e EULEX-it ka vepruar brenda kufirit të tyre të vlerësimit, se

është ruajtur ekuilibri i drejtë midis interesave të ndryshme në rastin në fjalë dhe rrjedhimisht refuzimit për ta lejuar ankuesin të hyjë në Kosovë ishte i justifikuar në rrethanat e rastit. Prandaj, nuk ka pasur shkelje të nenit 8 të Konventës.

30. Duke pasur parasysh gjetjet në bazë të nenit 8, Paneli konsideron se nuk është e nevojshme për të shqyrtuar ankesën sipas nenit 9 dhe nenit 2 të protokollit nr. 4 të Konventës veç e veç.

#### **PËR KËTO ARSYE, PANELI NJËZËRI**

1. *Konstaton* se nuk ka pasur shkelje të nenit 8 të Konventës;
2. *Konstaton* se nuk është e nevojshme të shqyrtohet lënda sipas nenit 9 dhe nenit 2 të protokollit nr. 4 të Konventës.

John J. RYAN  
Zyrtar i lartë ligjor

Magda MIERZEWSKA  
Kryesues